



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO - REPUBLIC OF KOSOVO
GJKATA KUSHTETUESE
USTAVNI SUD
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 24 korrik 2024
Nr. ref.:AGJ 2491/24

AKTGJYKIM

në

rastin nr. KI199/22

Parashtrues

N.P.T. "Arta XH"

Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktvendimit [E. Rev. nr. 75/20]
të Gjykatës Supreme të Kosovës të 1 gushtit 2022

GJKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Gresa Caka-Nimani, kryetare
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare
Safet Hoxha, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar dhe
Enver Peci, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

- Kërkesa është dorëzuar nga ndërmarrja "Arta XH", me seli në fshatin Begracë – Kaçanik (në tekstin e mëtejme: parashtruesi i kërkesës). Parashtruesi i kërkesës përfaqësohet nga Nezir Bytyqi, avokat nga Ferizaj.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës konteston kushtetutshmërinë e Aktvendimit [E. Rev. nr. 75/20] të Gjykatës Supreme të Kosovës, të 1 gushtit 2022.
3. Aktvendimi [E. Rev. nr. 75/20] i Gjykatës Supreme i 1 gushtit 2022, i është dorëzuar përfaqësuesit të parashtruesit të kërkesës më 14 tetor 2022.

Objekti i çështjes

4. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktvendimit [E. Rev. nr. 75/20] të Gjykatës Supreme të 1 gushtit 2022, përmes të cilit pretendohet se janë shkelur të drejtat dhe liritë themelore të parashtruesit të kërkesës të garantuara me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] në lidhje me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejme: KEDNj).

Baza juridike

5. Kërkesa bazohet në paragrafët 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, në nenin 22 (Procedimi i kërkesës) dhe nenin 47 (Kërkesa individuale) të Ligjit nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Ligji), si dhe në rregullin 32 [Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve] të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).
6. Më 7 korrik 2023, Rregullorja e punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës nr. 01/2023, u publikua në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës dhe hyri në fuqi 15 ditë pas publikimit të saj. Rrjedhimisht, gjatë shqyrtimit të kërkesës, Gjykata Kushtetuese i referohet dispozitave të Rregullores së lartcekur. Lidhur me këtë, konform rregullit 78 (Dispozitat kalimtare) të Rregullores së punës nr. 01/2023, përjashtimisht, dispozita të caktuara të Rregullores së punës nr. 01/2018, do të vazhdojnë të zbatohen në lëndët e regjistruara në Gjykatë përpara shfuqizimit të saj, vetëm nëse dhe për aq sa janë më të favorshme për palët.

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

7. Më 14 dhjetor 2022, parashtruesi i kërkesës e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
8. Më 16 dhjetor 2022, gjyqtari Enver Peci dha betimin para Presidentes së Republikës së Kosovës, me ç'rast filloi mandati i tij në Gjykatë.
9. Më 20 dhjetor 2022, Kryetarja e Gjykatës, me Vendimin [nr. GJR. KI199/22] caktoi gjyqtaren Remzije Istrefi-Peci gjyqtare raportuese dhe me Vendimin [nr. KSH. KI199/22] caktoi Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Selvete Gërzhaliu-Krasniqi (kryesuese), Safet Hoxha dhe Radomir Laban, anëtarë.
10. Më 23 janar 2023, Gjykata: **(i)** njoftoi parashtruesin për regjistrimin e kërkesës; **(ii)** i dërgoi një kopje të kërkesës Gjykatës Supreme dhe **(iii)** kërkoi nga Gjykata Komerciale në Prishtinë informata shtesë lidhur me datën kur parashtruesi i kërkesës ka pranuar Aktvendimin [E. Rev. nr. 75/20] e Gjykatës Supreme të 1 gushtit 2022.

11. Më 26 janar 2023, Gjykata pranoi një shkresë nga Gjykata Komerciale lidhur me kërkesën e Gjykatës.
12. Më 11 mars 2024, gjyqtari Jeton Bytyqi dha betimin para Presidentes së Republikës së Kosovës, me ç' rast filloi mandati i tij në Gjykatë.
13. Më 24 maj 2024, gjyqtari Jeton Bytyqi ka kërkuar nga kryetarja e Gjykatës që të përjashtohet nga procesi i vendimmarrjes në kërkesën konkrete.
14. Më 29 maj 2024, kryetarja e Gjykatës ka marrë vendimin [Ref. nr.: KK294/24] me të cilin e ka miratuar kërkesën për përjashtimin e gjyqtarit Jeton Bytyqi. Rrjedhimisht, gjyqtari Jeton Bytyqi nuk ka marrë pjesë në procesin e shqyrtimit dhe vendimmarrjes lidhur me kërkesën në fjalë.
15. Më 30 maj 2024, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e gjyqtarës raportuese dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës të deklarojë kërkesën të pranueshme.
16. Në të njëjtën ditë, Gjykata, me shtatë (7) vota për dhe një (1) kundër, vendosi që (i) të deklarojë kërkesën të pranueshme; (ii) të konstatojë se Aktvendimi [E. Rev. nr. 25/20] i 1 gushtit 2022 i Gjykatës Supreme, nuk është në përputhje me paragrafin 1 të nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës në lidhje me paragrafin 1 të nenit 6 (E drejta për një proces të rregullt) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

Përmbledhja e fakteve të rastit

17. Gjykata, nga shkresat e lëndës, vëren se rrethanat e rastit konkret ndërlidhen me marrëdhënien kontraktuese të cilën parashtruesi i kërkesës e kishte me ndërmarrjen "Sharr Beteiligungs GmbH" në lidhje me shitblerjen e hekurishteve të vjetra. Kontrata bazë është nënshkruar më 13 prill 2002, por për shkak të ndryshimit të çmimeve të materialeve në treg, kontrata është ripërtërirë në çdo tre vjet. Kontrata e fundit është ripërtërirë më 11 mars 2009.
18. Më 9 dhjetor 2010, Ndërmarrja Shoqërore "Sharr Cem" është privatizuar dhe e njëjta është regjistruar si subjekt i ri juridik "Sharr Cem" Sh.P.K. pranë Agjencisë së Regjistrimit të Bizneseve të Kosovës (ARBK). Bazuar në shkresat dhe pohimet e dorëzuara nga parashtruesi i kërkesës, Ndërmarrja e regjistruar "Sharr Cem" Sh.P.K. ka vazhduar të përmbushte detyrimet e saj kontraktuese që kishte ndaj parashtruesit të kërkesës.
19. Më 19 gusht 2011, ndërmarrja "Sharr Cem" Sh.P.K. ndaloi shitblerjen e hekurishteve të vjetra tek parashtruesi i kërkesës dhe shkëputi shprehimisht marrëdhënien kontraktuese me parashtruesin e kërkesës.
20. Më 12 shkurt 2014, parashtruesi i kërkesës parashtrroi padi në Gjykatën Themelore në Prishtinë (në tekstin e mëtejme: Gjykata Themelore) ndaj ndërmarrjes së regjistruar "Sharr Cem" Sh.P.K., duke kërkuar: **(i)** që kërkesëpadia e tij të aprovohet si e bazuar; dhe **(ii)** që në përputhje me nenin 124 të LMD-së t'i paguhet kompensimi i dëmit të shkaktuar me mospërmbushjen e detyrimeve kontraktuese nga i padituri duke filluar nga 19 gushti 2011 e deri në ditën e hartimit të ekspertizës, me kamatë ligjore nga dita e ushtrimit të padisë e deri në pagesën definitive, si dhe t'i paguhet shpenzimet e procedurës.
21. Në mbështetje të kësaj, paditësi i propozoi gjykatës që pas administrimit të provave me ekspertizë financiare, të përcaktojë lartësinë e dëmit real dhe fitimit të humbur.

22. Në një datë të pacaktuar, përfaqësuesi i të paditurës përmes përgjigjes në padi kërkoi që kërkesëpadija të refuzohet për shkak se palës së paditur i mungon legjitimiteti pasiv për të qenë palë në procedurë, ngase padia është paraqitur me supozimin se e paditura është pasardhëse e Ndërmarrjes “Sharr Beteiligungs GmbH”. Gjithashtu, lidhur me thirrjen e parashtruesit në nenin 124 të LMD-së, si bazë juridike për shpërblimin e dëmit, e paditura pretendoi se parashtruesi i kërkesës së pari është dashur të provojë që ndërmarrja “Sharr Beteiligungs GmbH” ka ndonjë detyrim kontraktues për të përmbushur apo se nuk i është garantuar e drejta për blerjen e hekurishteve të vjetra.
23. Më 21 janar 2016, në seancën përgatitore, parashtruesi i kërkesës e zgjeroi padinë, duke përfshirë edhe Ndërmarrjen “Sharr Beteiligungs GmbH” si të paditurën e dytë me të cilën parashtruesi i kërkesës lidhi kontratën më 13 prill 2002.
24. Më 12 shkurt 2016, e paditura, ndërmarrja “Sharr Cem” Sh.P.K., përmes një parashtruese të dorëzuar në Gjykatën Themelore, e kundërshtoi ndryshimin e padisë me arsyetimin se e njëjta është paraqitur pas afatit ligjor dhe në kundërshtim me nenin 258 të LPK-së, sepse një propozim i tillë është paraqitur pas mbajtjes së seancës përgatitore.
25. Më 17 tetor 2016, parashtruesi i kërkesës dorëzoi në Gjykatën Themelore një parashtrësë për sqarimin e zgjerimit të padisë, ku kishte arsyetuar se nuk qëndron kundërshtimi i të paditurës së parë dhe të paditurës së dytë se ndryshimi i padisë është paraqitur pas afatit ligjor, ngase parashtruesi i kërkesës e kishte kuptuar në seancë përgatitore se e paditura e dytë është ende subjekt juridik aktiv dhe e regjistruar në ARBK dhe në këtë mënyrë sipas nenit 258, paragrafit 4 të LPK-së, Gjykata do të duhej të lejonte ndryshimin e padisë edhe në rast të kundërshtimit në qoftë se përmbushen kushtet se a) paditësi pa fajin e tij, nuk ka mundur më parë ta ndryshojë padinë dhe b) i padituri ka mundësi të marrë pjesë në shqyrtimin e çështjes së ngritur me padinë e ndryshuar, pa u shtyrë seanca gjyqësore.
26. Më 18 nëntor 2016, në seancën e radhës përgatitore, parashtruesi i kërkesës sërish sqaroi kërkesën, duke kërkuar, “... që të realizohet një ekspertizë financiare për të nxjerrë si provë vlerën e kompensimit të dëmit, sasia dhe vlera e materialit të dalë nga prodhimi nga viti 2009 e deri në shkëputjen e kontratës“, si dhe nga shkëputja e kontratës e deri në hartimin e ekspertizës. Në anën tjetër, përfaqësuesi i të paditurës së parë “Sharr Cem” Sh.P.K. kërkoi që të përjashtohet nga çështja si palë e paditur, meqenëse gjykata ka pranuar zgjerimin e padisë duke përfshirë edhe ndërmarrjen “Sharr Beteiligungs GmbH”.
27. Më 22 dhjetor 2016, Gjykata Themelore në seancën përgatitore, përmes Aktvendimit [IV. C. nr. 453/14]: **(i)** aprovoi propozimin e parashtruesit të kërkesës për caktimin e një eksperti që do të përcaktonte vlerën e kompensimit të dëmit; dhe **(ii)** refuzoi propozimin e “Sharr Cem” Sh.P.K. që të përjashtohet nga kjo çështje kontestimore.
28. Më 18 shtator 2017, eksperti Sh. M. i zgjedhur nga Gjykata Themelore për të kryer ekspertizën financiare, dorëzoi ekspertizën në të cilën kishte konstatuar se nënshkruesi dhe pronari i “Sharr Cem” Sh.P.K. është nënshkrues i kontratës “Sharr Beteiligungs GmbH” me parashtruesin e kërkesës, të dyja këto subjekte të veçanta juridike. Më tej, eksperti i caktuar nga gjykata kishte konkluduar se “Sharr Cem” Sh.P.K. kishte vazhduar edhe për një vit shitblerjen e metaleve të dala jashtë përdorimit sipas Kontratës me nr. 94 të 11 marsit 2009 të lidhur ndërmjet ndërmarrjes “Sharr Beteiligungs GmbH” dhe parashtruesit të kërkesës. Si përfundim, ai kishte deklaruar që, në rast se gjykata konstaton se kontrata është shkëputur njëanshëm, do

të ishte e nevojshme një ekspertizë e re e cila do të ishte shumë më voluminoze dhe e kushtueshme.

29. Më 18 shkurt 2018, Gjykata Themelore në seancën e shqyrtimit kryesor përmes Aktvendimit [IV. C. nr. 453/14] refuzoi propozimin e parashtruesit të kërkesës për plotësimin e ekspertizës, sepse e njëjta kishte konkluduar se çështja është sqaruar mjaftueshëm nga ekspertiza dhe përgjigjet e ekspertit në këtë seancë.
30. Më 22 tetor 2018, Gjykata Themelore përmes Aktgjykimit [IV. EK. C. nr. 453/14]: **(i)** refuzoi kërkesëpadinë e parashtruesit të kërkesës të paraqitur ndaj të paditurës së parë “Sharr Cem” Sh.P.K., për shkak të mungesës së legjitimitetit pasiv; **(ii)** refuzoi kërkesëpadinë e paraqitur ndaj të paditurës së dytë “Sharr Beteiligungs GmbH, për shkak të mungesës së bazës ligjore; dhe **(iii)** vendosi që secila palë t’i bartë shpenzimet e veta procedurale.
31. Gjykata Themelore në arsyetimin e Aktgjykimit [IV. EK. C. nr. 453/14] kishte theksuar se:

“Paditësi nuk ka arritur të provojë gjatë procedurës se i padituri i parë, mundet me qenë palë në këtë procedurë, ngase me provat, deklaratimet e palëve ndërgjyqëse dhe nga ekspertiza e ekspertit financiar, gjykata ka konstatuar dhe ka vërtetuar, se të paditurës së parë “NewCO Sharr Cem” sh.p.k., i mungon legjitimiteti pasiv. Kjo vërtetohet në faktin se kur paditësi dhe e paditura e dytë e kanë lidhur kontratën për shitjen e mbeturinave-hekurishteve, e paditura e parë “Sharr Cem” sh.p.k. ende nuk ka qenë e formuar. Pastaj, gjykata askund nuk ka gjetur në shkresat e lëndës se ekziston ndonjë kontratë mbi cedimin, me të cilën e paditura e dytë ia ka ceduar kërkesat, apo edhe obligimet e të paditurës së parë. Sipas Kontratës mbi Privatizimin, me nr. 1791/2010 (...) është vërtetuar se nga e paditura e dytë nuk ka marrë kurrfarë obligimi-detyrimi për ndonjë punë tjetër juridike”.

[...]

“Paditësi gjithashtu nuk ka arritur që të provoj kërkesën e tij për dëmin që i është shkaktuar nga veprimet e të paditurës së dytë. Edhe pse qëndron fakti se e paditura e dytë “Sharr Beteiligungs GmbH” kishte lidhur kontratë për shitjen e mbeturinave të paditëses, në kohën derisa e kishte nën komercializim N.Sh “Sharr Cem”, me rastin e shitjes së kësaj kompanie nga AKP-ja, kjo kontratë është shkëputur, gjegjësisht nuk ka qenë e obligueshme për të paditurën e parë, sepse e paditura e parë nuk ka pasur kurrfarë obligimi ta mbaj në fuqi të njëjtën. Nga kontrata nuk shihet asnjë detyrim që e paditura e dytë t’i shet në mënyrë të pakushtëzuar mbeturinat-hekur paditëses, brenda ndonjë periudhe të caktuar kohore, që do të thotë se ka qenë në diskrecionin e plotë të paditurës së dytë, ngase objekt i kontratës ishin hekurishtet e ujetra të nxjerra jashtë përdorimi”.

[...]

“E paditura e dytë, “Sharr Beteiligungs GmbH” derisa e ka pasur nën komercializim N.Sh. “Sharr Cem”, materiali i mbetur-hekurishtet kanë qenë nën menaxhimin e saj, ashtu që edhe kontrata e lidhur për shitjen e hekurishteve me kompaninë “Arta XH” ka qenë obliguese për të. Me rastin e shitjes së kompanisë N.Sh “Sharr Cem” me spinof special, “NewCO Sharr Cem” ka marrë nën menaxhim edhe fabrikën, edhe mbeturinat, që dalin nga prodhimi, ashtu që kontrata e lidhur në mes kompanisë “Sharr Beteiligungs GmbH” dhe “Arta XH” ka mbetur pa objekt, nga shkak se objekt i saj kanë qenë mbeturinat-hekurishte

të dala nga prodhimi, andaj kur zhduket apo kur objekti i kontratës kalon në një subjekt tjetër, përveç nëse subjekti i cili është bërë pronar i pranon kërkesat dhe obligimet të dala nga ky objekt i kontratës, i pranon vet me kontratë të re, apo me vet kontratën e shitjes”.

“Nisur nga kjo edhe eksperti gjatë përpilimit të ekspertizës nuk ka mundur ta përcaktoj vëllimin e dëmit, që i është shkaktuar paditësit, ngase eksperti nuk ka mundur të gjej gfarëdo dëshmie që tregon se pala paditëse ka pasur fitim të humbur”.

“Pala paditëse thirret në nenin 124 të LMD-së për shpërblimin e dëmit, gjë që është kërkesë e pabazuar, për shkak se për të fituar të drejtën e kompensimit të dëmit, paditësi së pari është dashur që me dëshmi të provoj se “Sharr Beteiligungs GmbH” është e obliguar të përmbush një detyrim kontraktual, ndërsa nga kontrata për shitjen e materialëve të mbetura paditësit nuk i ka garantuar të drejtën për blerjen e ndonjë hekurishte. (...) Përgjegjësia për kompensimin e dëmit të shkaktuar është e përcaktuar me nenin 154.1 të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve, ku është përcaktuar se “Kush i shkaktonte tjetrin dëmin ka për detyrë ta kompensojë, në qoftë se nuk provon se dëmi ka lindur pa fajin e tij”. (...) Meqenëse paditësi nuk ka arritur të provoj se i padituri ka ndërmarrë veprimet e shkaktimit të dëmit, gjykata erdhi në përfundimin se kërkesëpadia është e pabazuar dhe të njëjtën e refuzoi në tërësi”.

32. Brenda afatit ligjor, parashtruesi i kërkesës paraqiti ankesë në Gjykatën e Apelit kundër Aktgjykimit [IV. C. nr. 453/14] të Gjykatës Themelore të 22 tetorit 2018 për shkak të **a)** shkeljeve të dispozitave të procedurës kontestimore; **b)** vërtetimit të gabuar të gjendjes faktike; dhe **c)** zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, dhe kërkoi që: **(i)** ankesa e tij të pranohet si e themeltë dhe **(ii)** të priset Aktgjykimi i goditur me ankesë dhe çështja të kthehet në gjykatën e shkallës së parë në rivendosje.
33. Sa i përket pretendimit për **(a)** shkeljet thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, parashtruesi i kërkesës në ankesën e tij kishte theksuar se: “Aktgjykimi i atakuar ka të meta për shkak të cilave nuk mund të ekzaminohet sepse dispozitivi i këtij aktgjykimi është i pakuptueshëm dhe kontradiktor me vetveten dhe nuk janë treguar fare arsyet për faktet vendimtare ..., ashtu që ekziston shkelja thelbësore e dispozitës së nenit 182.1 dhe 182.2, nënpika (n) e lidhur me nenin 2.1 të LPK-së”. Ndërsa, lidhur me pretendimin për **(b)** vërtetimin jo të plotë dhe të gabuar të gjendjes faktike, parashtruesi i kërkesës kishte potencuar se: “Në seancën e shqyrtimit të kësaj çështje kontestimore, të dt.18.11.2016, i autorizuari i paditësit, ka propozuar nxjerrjen e provës me ekspertizë financiare, me detyrim që eksperti të vlerësoj sasinë dhe vlerën e materialit të dalë jashtë prodhimit të cilin paditësi ka pasur ta pranoj nga i padituri i parë dhe i padituri i dytë, të cilin gjatë marrëdhënies kontraktuese të paditësit dhe të paditurit të dytë dhe marrëdhënies kontraktuese të paditësit dhe të paditurit të parë, dhe pas shkëputjes së saj të njëanshme nga i padituri i parë, të paditurit ua kanë dhënë personave të tjerë (...), ndërsa me aktvendimin e saj (Gjykata Themelore) të datës 22.12.2016, për nxjerrjen e provës me ekspertizë, gjykata përveç këtyre detyrave, të përcaktimit të sasisë dhe vlerës së materialeve të dhëna personave të tjerë, për të vlerësuar fitimin e munguar të paditësit, ekspertit i ka dhënë edhe detyra që nuk janë të natyrës financiare, por janë të natyrës juridike si: kur është privatizuar dhe formuar i padituri i parë, a ka pasur kontratë shitblerëse në mes paditësit dhe të paditurit të parë...”. Në këtë drejtim, parashtruesi i kërkesës kundërshtoi refuzimin e propozimit nga Gjykata Themelore që të caktohet një ekspertizë tjetër për të përcaktuar vlerën e dëmit potencial që ai pretendonte se i është shkaktuar nga ky kontest, duke theksuar si në vijim: “... i autorizuari i paditësit me parashtruesin e datës 22.02.2018, i ka propozuar gjyqtarit të çështjes që të evitohet

këtë të metë procedurale, në detyrimin e të njëjtit ekspert që ta përmbushë edhe këtë detyrë apo në angazhimin e ekspertit tjetër për nxjerrjen e kësaj prove, jashtë seancës dëgjimore (...) mirëpo gjyqtari i çështjes nuk ka reflektuar në këtë drejtim". Ndërsa, sa i përket pretendimit në lidhje me (c) zbatimin e gabuar të së drejtës materiale, parashtruesi i kërkesës konkludoi se Gjykata Themelore gabimisht zbatoi dispozitën e nenit 154.1 të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve, ngase, sipas tij, kemi të bëjmë me dëmin kontraktues për shkak të shkeljes së njëanshme të kontratës, e jo me dëmin deliktor ku kërkohet fajësia e shkeljesit.

34. Brenda afatit ligjor, përfaqësuesi i të paditurës paraqiti përgjigje në ankesë, me propozim që Gjykata e Apelit të refuzojë ankesën dhe të vërtetojë në tërësi Aktgjykimin [IV. C. nr. 453/14] e Gjykatës Themelore të 22 tetorit 2018.
35. Më 4 gusht 2020, Gjykata e Apelit nëpërmjet Aktgjykimit [Ae. nr. 306/2018] refuzoi ankesën e parashtruesit të kërkesës si të pabazuar dhe vërtetoi në tërësi Aktgjykimin [IV. EK. C. nr. 453/2015] e Gjykatës Themelore të 22 tetorit 2018.
36. Në arsyetimin e Aktgjykimit [Ae. nr. 306/2018], Gjykata e Apelit konkludoi si në vijim:

"Gjykata e shkallës së parë pas administrimit të provave ka konstatuar se paditësi nuk ka arritur të provojë gjatë procedurës se i padituri i parë mundet me qenë palë në këtë procedure, ngase me provat deklarimet e palëve ndërgjyqës, ngase me provat deklarimet e palëve ndërgjyqëse dhe nga ekspertiza e ekspertit financiar është vërtetuar se të paditurës së parë "New CO Sharr Cem" sh.p.k. i mungon legjitimiteti pasiv. Kjo vërtetohet në faktin se kur paditësi dhe e paditura e dytë e kanë lidhur kontratën për shitjen e mbeturinave hekurishteve, e paditura e parë "Sharr Cem" sh.p.k. ende nuk ka qenë e formuar. Se nuk ka legjitimitet pasiv në këtë çështje e paditura e parë "Sharr Cem" sh.p.k., e vërteton edhe fakti se e paditura e dytë "Sharr Beteiligungs GmbH" ende është aktive ngase është deklaruese aktive e tatimeve pranë ATK-së. Edhe pse të dyja këto kompani janë në pronësi të të njëjtit subjekt juridik të huaj, mirëpo të njëjtat nuk kanë asnjë ndikim në personalitetin e tyre të veçantë juridik".

[...]

"Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë e aprovon vlerësimin juridik të gjykatës së shkallës së parë si të rregullt dhe të ligjshëm (...) vlerëson se gjykata e shkallës së parë, duke vërtetuar në mënyrë të plotë gjendjen faktike, drejt ka zbatuar dispozitat e procedurës kontestimore dhe të drejtën materiale kur ka gjetur se kërkesëpadia e paditësit është e pabazuar".

"Janë të pabazuara thëniet në ankesën e së paditurës se aktgjykimi i goditur është marrë me shkelje qenësore të dispozitës nga neni 182, par.2 pika n) të Ligjit për Procedurën Kontestimore, se aktgjykimi ka mangësi, dispozitivi i aktgjykimit është i pakuptueshëm dhe në kundërshtim me vetveten dhe nuk ka arsye mbi fakte vendimtare. Sipas vlerësimit të kësaj gjykate, gjykata e shkallës së parë ka dhënë arsye të mjaftueshme dhe bindëse kur ka refuzuar kërkesëpadinë e paditësit dhe vendimin e saj e mbështet në provat e administruara ...".

"Po ashtu nuk qëndrojnë thëniet e të paditurës në ankesë, se aktgjykimi i atakuar është marrë në bazë të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, sepse nga provat e administruara rezulton se, gjykata e shkallës së parë drejtë ka vërtetuar fakte të cilat kanë të bëjnë me ekzistimin respektivisht mosekzistimin e

borxhit të së paditurës dhe se nuk ekziston asnjë bazë ligjore e vlefshme me të cilën është krijuar ndonjë obligim i të së paditurës në raport me paditësen”.

“Sipas nenit 319.1 të LPK-së, paditësi ka pasur për detyrë të provojë faktet mbi të cilat i bazon kërkimet dhe pretendimet e tij, ndërsa ai nuk i ka ofruar gjykatës prova bindëse se ekziston përgjegjësia e të paditurës për detyrimet e krijuara”.

37. Më 28 gusht 2020, parashtruesi i kërkesës paraqiti revizion në Gjykatën Supreme për shkak të: **a)** shkeljeve thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore të parapara në nenin 182, paragrafi 2 të LPK-së nga gjykata e shkallës së dytë; **b)** shkeljeve thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182, paragrafi 2 nënparagrafi n) dhe neni 2.1 i LPK-së nga gjykata e shkallës së parë; dhe **c)** aplikimit të gabuar të së drejtës materiale nga të dyja gjykatat, duke kërkuar nga Gjykata Supreme që ajo: **(i)** të pranojë revizionin si të bazuar; **(ii)** të prishë Aktgjykimin [Ae. nr. 306/2018] e Gjykatës së Apelit të 4 gushtit 2020 dhe Aktgjykimin [IV. C. nr. 453/2014] e Gjykatës Themelore të 22 tetorit 2018; dhe **(iii)** ta kthejë lëndën në gjykatën e shkallës së parë në rigjykim.
38. Në një datë të pacaktuar, pala e paditur ka paraqitur përgjigje në revizion dhe ka kërkuar që të hidhet poshtë si i palejuar revizioni i paraqitur nga parashtruesi i kërkesës dhe të vërtetohen aktgjykimet e shkallës së parë dhe të dytë.
39. Më 1 gusht 2022, Gjykata Supreme përmes Aktvendimit [E. Re. nr. 75/20] e hodhi poshtë si të palejuar revizionin e paraqitur nga parashtruesi i kërkesës me arsyetimin si në vijim:

“Me nenin 508, të LPK, përcaktohet se: “Revizioni në kontestet tregtare nuk lejohet në qoftë se vlera e objektit të kontestit në pjesën e goditur të aktgjykimit të formës së prerë nuk i kalon 10,000 €”.

“Me nenin 30, paragraf 1 të LPK-së, përcaktohet se: “Paditësi ka për detyrë që në kontestet pasurore - juridike, në padi të përcaktoj vlerën e objektit të kontestit...”.

“Nga interpretimi i këtyre dispozitave ligjore, Gjykata Supreme erdhi në përfundim se revizioni nuk lejohet kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës Ac. nr. 306/18, të datës 04.08.2020, për arsye se dispozitat e cituara i referohen lejueshmërisë së revizionit e kushtëzuar me vlerën e kontestit e cila duhet të jetë mbi 10,000 euro (...) Në këtë rast vlera e kontestit e goditur me revizion nuk është mbi 10,000 €, gjegjësisht pala paditëse me padi nuk e ka përcaktuar vlerën e kontestit, e nëse i referohemi taksës gjyqësore për padi në lartësi prej 15 €, të cilën e ka paguar pala paditëse, nuk e tejkalon vlerën e kontestit mbi 10,000 €, bazuar në udhëzimet administrative për unifikimet e taksave gjyqësore dhe po ashtu natyra e kontestit nuk përbën përjashtim për lejueshmërinë e revizionit (përjashtimet pavarësisht vlerës), prandaj në këtë rast për shkak të vlerës së kontestit, revizioni është i palejuar”.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

40. Parashtruesi i kërkesës pretendon se Gjykata Supreme përmes Aktvendimit [E. Rev. 75/20] të 1 gushtit e ka shkelur të drejtën e tij për “qasje në gjykatë”, të garantuar me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të KEDNj-së.
41. Përkitazi me pretendimin për shkelje të nenit 31, parashtruesi i kërkesës pretendon se nëse një mjet juridik është i paraparë dhe një gjykatë vendore refuzon të trajtojë

meritat e rastit, kjo rezulton në shkelje të së drejtës për “qasje në gjykatë” të garantuar me nenin 31 të Kushtetutës dhe me nenin 6 të KEDNJ-së, andaj i njëjti thekson se: “... në rastin konkret, mjeti juridik ka qenë në dispozicion të parashtruesit sipas legjislacionit në fuqi dhe se Gjykata Supreme ka cenuar qasjen në Gjykatë duke hedhur poshtë revizionin në kundërshtim me ligjin, pasi neni 211 i LPK-së përcakton “Kundër aktgjykimin të shkallës së dytë, palët mund të paraqesin revizion brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën u është dorëzuar aktgjykimi”. Pra, e drejta për revizion ndaj aktgjykimin të shkallës së dytë, në këtë rast të Gjykatës së Apelit është e garantuar me ligj”.

42. Bazuar në sa më sipër, parashtruesi i kërkesës konkludon se revizioni mund të hidhet poshtë vetëm nëse vlera e kontestit nuk kalon shumë prej 3,000 €, ndërsa në kontestet tregtare nëse nuk tejkalon shumë prej 10,000 €, por në rastin konkret shuma e vlerës së kontestit nuk është përcaktuar, dhe për këtë arsye i njëjti nuk mund të hidhet poshtë. Lidhur me këtë, parashtruesi i kërkesës thekson se: “Për më tepër, sipas dispozitës së nenit 36 të LPK-së, “Në qoftë se paditësi nuk e ka përmendur fare vlerën e objektit të kontestit në padinë e paraqitur në gjykatë, apo në qoftë se ai vlerën e tillë e ka caktuar tepër të lartë apo shumë më të vogël se që është realisht, atëherë gjykata sipas detyrës zyrtare, apo sipas prapësimit të palës së paditur, më së voni në seancën përgatitore, e nëse kjo nuk është mbajtur, atëherë në seancën për shqyrtimin kryesor të çështjes (...) do ta caktoj, përkatësisht do ta verifikojë saktësinë e vlerës së treguar në padi nga paditësi”. Pra, është e qartë që sipas ligjit nëse paditësi nuk e ka caktuar vlerën e kontestit sipas nenit 30 të LPK-së, atëherë detyrë e gjykatës është që “ex officio” të njëjtën ta caktojë. Gjithashtu, në LPK nuk përcaktohet që nuk lejohet revizioni në kontestet pa vlerë të përcaktuar”.
43. Në këtë drejtim, parashtruesi i kërkesës potencon se ka propozuar që shuma e vlerës së objektit të kontestit të përcaktohet me plotësimin e ekspertizës financiare, propozim i cili nuk është aprovuar nga Gjykata Themelore dhe si rezultat ai thekson se: “... Gj. Themelore e refuzoi këtë propozim me arsyetimin gjoja se kjo çështje është sqaruar mjaftueshëm me këtë ekspertizë, ashtu që sasia dhe vlera e kësaj kërkesëpadie ngeli e papërcaktuar, dhe kjo me lëshimin e gjykatës së shkallës së parë, sepse sipas dispozitës së nenit 36 të LPK-së nëse paditësi nuk e ka caktuar vlerën e kontestit sipas nenit 30 të LPK-së, atëherë detyrë e gjykatës është që “ex officio” të njëjtën ta caktojë”.
44. Në fund, parashtruesi i kërkesës thekson se shuma prej 15 €, të cilën e kishte paguar në emër të taksës gjyqësore, nuk mund të shërbejë si arsye për përcaktimin e vlerës së kontestit, sepse e njëjta është paguar për kontestin në të cilin shuma nuk është caktuar në momentin e paraqitjes së padisë, por është kërkuar që një veprim i tillë të ndërmerret nga Gjykata Themelore.

Dispozitat përkatëse kushtetuese dhe ligjore

KUSHTETUTA E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

Neni 31

[E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm]

1. “Çdokujt i garantohet mbrojtje e barabartë e të drejtave në procedurë para gjykatave, organeve të tjera shtetërore dhe bartësve të kompetencave publike.
2. Çdokush gëzon të drejtën për shqyrtim publik të drejtë dhe të paanshëm lidhur me vendimet për të drejtat dhe obligimet ose për cilëndo akuzë penale që

ngrihet kundër saj/tij brenda një afati të arsyeshëm, nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e themeluar me ligj”.
[...]

KONVENTA EVROPIANE PËR TË DREJTAT E NJERIUT

Neni 6.1 (E drejta për një proces të rregullt)

1. *“Çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme ..., e cila do të vendosë si për mosmarrëveshjet në lidhje me të drejtat dhe detyrimet e tij të natyrës civile ...”.*
[...]

Dispozitat përkatëse ligjore

LIGJI Nr. 03/L-006 PËR PROCEDURËN KONTESTIMORE

4. Përcaktimi i vlerës së objektit të kontestit

Neni 30 (pa titull)

“30.1 Paditësi ka për detyrë që, në kontestet pasurore-juridike, në padi ta përcaktoj vlerën e objektit të kontestit. Si vlerë e objektit të kontestit merret parasysh vetëm vlera e kërkesës kryesore”.

30.2 Kamatat, shpenzimet procedurale, penalitetet e kontraktuara dhe kërkesat tjera ankesore, nuk merren parasysh në qoftë se nuk përbëjnë kërkesë kryesore”.

Neni 36 (pa titull)

“Në qoftë se paditësi nuk e ka përmendur fare vlerën e objektit të kontestit në padinë e paraqitur në gjykatë, apo në qoftë se ai vlerën e tillë e ka caktuar tepër të lartë apo shumë më të vogël se që është ajo realisht, atëherë gjykata sipas detyrës zyrtare, apo sipas prapësimit të palës së paditur, më së voni në seancën përgatitore, e nëse kjo nuk është mbajtur, atëherë në seancën për shqyrtimin kryesor të çështjes juridike, por para se të filloj shqyrtimi i çështjes kryesore, shpejtë dhe në mënyrë të përshtatshme do ta caktoj, përkatësisht do ta verifikojë saktësinë e vlerës së treguar në padi nga paditësi. Në rast të këtillë gjykata vendosë me aktvendim kundër të cilit nuk lejohet ankimi”.

REVIZIONI Neni 211.1

“Kundër aktgjykimin të gjykatës së shkallës së dytë, palët mund të paraqesin revizion brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën u është dorëzuar aktgjykim”.

[...]

KREU XXX PROCEDURA NË KONTESTET TREGTARE

[...]

**Neni 508
(pa titull)**

“Revizioni në kontestet tregtare nuk lejohet në qoftë se vlera e objektit të kontestit në pjesën e goditur të aktgjykimit të formës së prerë nuk i kalon 10.000 Euro”.

**LIGJI Nr. 04/L-118 PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJIT
NR. 03/L-006 PËR PROCEDURËN KONTESTIMORE**

**Neni 11
(pa titull)**

“Neni 218 i ligjit bazik riformulohet me tekstin si në vijim:

Neni 218

1. Revizioni i paraqitur pas kohe, i palejueshëm apo jo i plotë, hudhet poshtë me aktvendim të Gjykatës së shkallës së parë pa mbajtur seancë gjyqësore.

2. Revizioni është i palejueshëm nëse:

a) e ka paraqitur personi i cili nuk është i autorizuar për paraqitjen e revizionit;

b) revizionin e ka paraqitur personi i cili e ka tërhequr revizionin;

c) nëse personi i cili ka paraqitur revizionin nuk ka interes për paraqitjen e tij;

d) është paraqitur revizioni kundër aktgjykimit kundër të cilit sipas ligjit nuk mund të paraqitet”.

Pranueshmëria e kërkesës

45. Gjykata fillimisht shqyrton nëse kërkesa i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë, të parashikuara me Ligj dhe të specifikuara më tej me Rregullore të punës.

46. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet paragrafëve 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, të cilët përcaktojnë:

“1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.

[...]

7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.

47. Gjykata i referohet edhe paragrafit 4 të nenit 21 [Parimet e Përgjithshme] të Kushtetutës, i cili përcakton: *“Të drejtat dhe liritë themelore të parashikuara në Kushtetutë, vlejné edhe për personat juridikë, për aq sa janë të zbatueshme”.*

48. Në këtë aspekt, Gjykata fillimisht vëren se parashtuesi i kërkesës ka të drejtë të dorëzojë ankesë kushtetuese, duke iu referuar shkeljeve të pretenduara të të drejtave dhe lirive themelore, që vlejné për individët dhe personat juridikë (shih rastin e Gjykatës KI41/09, parashtues *Universiteti AAB-RIINVEST L.L.C.*, Aktvendim për papranueshmëri, i 3 shkurtit 2010, paragrafi 14).

49. Gjykata në vazhdim shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, siç përcaktohen më tej në Ligj, përkatësisht me nenet 47, 48 dhe 49 të Ligjit, që përcaktojnë:

Neni 47
[Kërkesa individuale]

“1. Çdo individ ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata Kushtetuese mbrojtje juridike në rast se pretendon se të drejtat dhe liritë e tija individuale të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik.

2. Individidi mund ta ngritë kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.

Neni 48
[Saktësimi i kërkesës]

“Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj”.

Neni 49
[Afatet]

“Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajve. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor. Në të gjitha rastet e tjera, afati fillon të ecë në ditën kur vendimi ose akti është shpallur publikisht ...”.

50. Përkitazi me përmbushjen e kriterëve të lartcekura, Gjykata vlerëson se parashtruesi i kërkesës: i. është palë e autorizuar, në kuptim të nenit 113.7 të Kushtetutës; ii. konteston kushtetutshmërinë e Aktvendimit [E. Rev. 75/20] të Gjykatës Supreme të 1 gushtit 2022; iii. ka shteruar të gjitha mjetet juridike në dispozicion, në kuptim të nenit 113.7 të Kushtetutës dhe nenit 47.2 të Ligjit; iv. ka specifikuar qartë të drejtat e garantuara me Kushtetutë, të cilat pretendon se i janë shkelur, në pajtim me kërkesat e nenit 48 të Ligjit; dhe v. kërkesën e ka dorëzuar brenda afatit ligjor prej 4 (katër) muajsh, siç përcaktohet me nenin 49 të Ligjit.
51. Megjithatë, përveç kësaj, Gjykata shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara në rregullin 34 [Kriteret e pranueshmërisë], përkatësisht me dispozitat (1) (d) dhe (2) të rregullit 34 të Rregullores së punës, që përcaktojnë:

(1) “Gjykata mund ta konsiderojë një kërkesë të pranueshme nëse:

(...)

(d) Kërkesa qartëson saktësisht dhe në mënyrë adekuate paraqet faktet dhe pretendimet për shkelje të të drejtave apo dispozitave kushtetuese.

(2) Gjykata mund ta konsiderojë kërkesën të papranueshme nëse kërkesa është qartazi e pabazuar, kur parashtruesi/ja nuk dëshmon dhe nuk mbështetë në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij/saj”.

52. Gjykata konsideron se kërkesa ngre pretendime serioze kushtetuese të arsyetuara *prima facie* dhe se ajo nuk është qartazi e pabazuar në kuptim të rregullit 34 (2) të

Rregullores së punës. Rrjedhimisht, Gjykata vlerëson se kërkesa e parashtruesit i përmbush kushtet për vlerësim në merita.

Meritat e kërkesës

53. Në kontekst të vlerësimit të pranueshmërisë së kërkesës, Gjykata fillimisht do të rikujtojë esencën e rastit si dhe pretendimet përkatëse të parashtruesit të kërkesës, në vlerësimin e të cilave, Gjykata do të aplikojë standardet e praktikës gjyqësore të GjEDNj-së, në harmoni me të cilën, në bazë të nenit 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] të Kushtetutës, ajo është e detyruar të interpretojë të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me Kushtetutë.
54. Në fillim, Gjykata rikujton se thelbi i kontestit gjyqësor pranë gjykatave të rregullta ka të bëjë me mospërmbushjen e detyrimeve kontraktuese nga ndërmarrja “Sharr Beteiligungs GmbH” ndaj parashtruesit të kërkesës. Më konkretisht, parashtruesi i kërkesës, më 13 prill 2002, ka lidhur kontratën bazë me ndërmarrjen “Sharr Beteiligungs GmbH”, në të cilën palët kanë përcaktuar të drejtat dhe detyrimet e tyre. Në bazë të kësaj kontrate, ndërmarrja “Sharr Beteiligungs GmbH” mori përsipër t'i shiste hekurishtet e vjetra vetëm parashtruesit të kërkesës, ndërsa parashtruesi i kërkesës mori përsipër të blinte të gjitha hekurishtet e vjetra nga ndërmarrja “Sharr Beteiligungs GmbH”. Më 9 dhjetor 2010, ndërmarrja “Sharr Beteiligungs GmbH” është privatizuar dhe me këtë rast është regjistruar si person i ri juridik, ndërmarrja “Sharr Cem” Sh.P.K. Mirëpo, pavarësisht këtij fakti, sipas shkresave të lëndës dhe pohimeve të parashtruesit të kërkesës ndërmarrja e saporegjistruar “Sharr Cem” Sh.P.K., vazhdoi me përmbushjen e detyrimeve kontraktuese nga kontrata deri më 19 gusht 2011, kur në mënyrë të njëanshme shkëputi kontratën me parashtruesin e kërkesës.
55. Parashtruesi i kërkesës inicioi procedurën gjyqësore, pranë Gjykatës Themelore për shkak të ndërprerjes së njëanshme të përmbushjes së detyrimit kontraktues, duke paraqitur kërkesëpadinë në të cilën nuk e precizoi vlerën e kontestit, por kërkoi pranë gjykatës kompetente që, në përputhje me nenin 124 të LMD-së, t'i paguhet kompensimi i dëmit për shkak të mospërmbushjes së detyrimeve kontraktuese nga e paditura dhe atë nga 19 gushti 2011 deri në ditën e hartimit të ekspertizës financiare, me kamatë ligjore duke filluar nga data e parashtrimit të padisë e deri në pagesën definitive, si dhe t'i paguhen shpenzimet e procedurës parashtruesi i kërkesës gjithashtu kërkoi që vlera e dëmit të përcaktohet me prova dhe ekspertizë financiare nga eksperti financiar. Të njëjtën kërkesë respektivisht që vlera e dëmit të përcaktohet me prova dhe ekspertizë financiare nga eksperti financiar parashtruesi i kërkesës e kishte paraqitur edhe në kërkesëpadinë e zgjeruar, si dhe gjatë shqyrtimit gjyqësor të mbajtur më 18 nëntor 2016.
56. Kërkesëpadia e parashtruesit të kërkesës është refuzuar në tërësi nga Gjykata Themelore. Kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore, parashtruesi i kërkesës parashtroi ankesë në Gjykatën e Apelit, duke kontestuar gjetjet e Gjykatës Themelore, duke përfshirë edhe faktin se Gjykata Themelore nuk e përcaktoi vlerën e kontestit edhe pse kjo sipas parashtruesit të kërkesës ishte detyrë e saj. Gjykata e Apelit e refuzoi ankesën e parashtruesit të kërkesës si të pabazuar. Duke pasur parasysh këtë, parashtruesi i kërkesës paraqiti kërkesën për revizion, e cila është refuzuar nga Gjykata Supreme për arsye procedurale, duke arritur në përfundimin se kërkesëpadia e parashtruesit të kërkesës nuk e kalon vlerën prej 10,000 €.
57. Gjykata Supreme refuzoi kërkesën e parashtruesit për revizion për arsye procedurale e shtyu parashtruesin të paraqiste kërkesën në Gjykatë, duke pretenduar se ky aktvendim i Gjykatës Supreme cenon të drejtën e tij për “qasje në gjykatë” të garantuar me nenin 31 të Kushtetutës dhe nenin 6 të KEDNj-së. Më konkretisht,

parashtruesi theksoi se ai shfrytëzoi mjetin juridik në dispozicion sipas legjislacionit në fuqi dhe se Gjykata Supreme i cenoi qasjen në gjykatë duke refuzuar revizionin në kundërshtim me ligjin, sepse neni 211 i LPK-së përcakton se, "*Kundër aktgjykimit të gjykatës së shkallës së dytë, palët mund të paraqesin revizion brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën u është dorëzuar aktgjykimi*". Prandaj, e drejta e revizionit ndaj aktgjykimit të shkallës së dytë, e në këtë rast ndaj atij të Gjykatës së Apelit, është e garantuar me ligj.

58. Bazuar në sa më sipër, parashtruesi i kërkesës thekson se revizioni mund të hidhet poshtë vetëm nëse vlera e kontestit nuk e kalon shumë prej 3,000 €, ndërsa në kontestet tregtare nëse nuk e kalon shumë prej 10,000 €, por në rastin konkret shuma e vlerës së kontestit nuk është përcaktuar dhe për këtë arsye i njëjti nuk mund të hidhet poshtë. Lidhur me këtë, parashtruesi i kërkesës pretendon: "*Për më tepër, sipas dispozitës së nenit 36 të LPK-së, "Në qoftë se paditësi nuk e ka përmendur fare vlerën e objektit të kontestit në padinë e paraqitur në gjykatë, apo në qoftë se ai vlerën e tillë e ka caktuar tepër të lartë apo shumë më të vogël se që është realisht, atëherë gjykata sipas detyrës zyrtare, apo sipas prapësimit të palës së paditur, më së voni në seancën përgatitore, e nëse kjo nuk është mbajtur, atëherë në seancën për shqyrtimin kryesor të çështjes (...) do ta caktoj, përkatësisht do ta verifikojë saktësinë e vlerës së treguar në padi nga paditësi*". Prandaj, është e qartë se sipas ligjit, në rast se paditësi nuk ka përcaktuar vlerën e kontestit sipas nenit 30 të LPK-së, atëherë është detyrë e gjykatës ta përcaktojë këtë vlerë "*ex officio*". Gjithashtu, parashtruesi thekson se në LPK nuk është përcaktuar se revizioni nuk është i lejuar në kontestet pa vlerë të përcaktuar.
59. Në këtë drejtim, parashtruesi i kërkesës thekson se ai ka propozuar që shuma e vlerës së kontestit të përcaktohet me plotësimin e ekspertizës financiare, por ky propozim nuk është aprovuar as nga Gjykata Themelore dhe as nga Gjykata e Apelit, edhe pse kjo, ndër të tjera, ishte kërkesa e tij ankimore.
60. Prandaj, Gjykata, para se të analizojë pretendimet e parashtruesit të kërkesës, potencon se ajo në këtë kërkesë nuk do të merret me marrëdhënien kontraktuese ndërmjet parashtruesit të kërkesës dhe të paditurës, dhe as me legjitimitetin juridik të palëve në procedurën e rregullt gjyqësore, por do të fokusohet ekskluzivisht në çështjen e shkeljes së mundshme të nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNj-së, në kontekstin e shkeljes së të drejtës për qasje në gjykatë, përkatësisht nëse lëshimet procedurale të gjykatave të rregullta rezultuan me situatën që kërkesa e parashtruesit të hidhet poshtë nga Gjykata Supreme për arsye se kjo e fundit, kur vendosi për lejueshmërinë e revizionit, mori një qasje formaliste, duke mos marrë parasysh lëshimet e mundshme procedurale të gjykatave të shkallës më të ulët.
61. Rasti konkret i cili shqyrtohet nga Gjykata lidhet me mënyrën në të cilën kushtet ekzistuese *ratione valoris* kanë vepruar në çështjen e parashtruesit të kërkesës. Konkretisht, rasti ka të bëjë me çështjen nëse Gjykata Supreme, në rrethanat e veçanta të rastit, duke e deklaruar revizionin e parashtruesit të kërkesës të palejuar, ka zbatuar formalizëm të tepruar dhe ka ndikuar në mënyrë joproporcionale në mundësinë e saj për të gjykuar për thelbin e rastit në kontestin e tij pronësor, siç garantohet me përcaktimet ligjore. Në kontekst të lartcekurave, Gjykata do të shqyrtojë nëse veprimi i gjykatave të shkallës më të ulët dhe ndërmarrja/mosndërmarrja e veprimeve procedurale nga këto të fundit, kanë rezultuar me kufizimin e qasjes në gjykatën më të lartë.
62. Në zbatimin e kësaj analize, Gjykata fillimisht do t'i referohet praktikës gjyqësore të Gjykatës, si dhe praktikës gjyqësore të GjEDNj-së lidhur me kufizimet e qasjes në gjykatë, duke përfshirë praktikën gjyqësore lidhur me kufizimet e qasjes në gjykatat

më të larta. Më pas do të analizojë praktikën gjyqësore lidhur me çështjen e kufizimit *ratione valoris* të qasjes në gjykatat më të larta, si dhe me çështjet e veçanta të proporcionalitetit që shtrohen në këtë rast, gjegjësisht, kush duhet t'i bartë pasojat e dëmshme të gabimeve të bëra gjatë procedurës, dhe me çështjen e ekzistencës së formalizmit të tepruar.

63. Andaj, Gjykata duhet të përcaktojë nëse lëshimi i Gjykatës Themelore për të vepruar në pajtim me nenin 36 të LPK-së dhe për të përcaktuar vlerën e kontestit rezultoi me situatën ku Gjykata Supreme refuzoi kërkesën e tij për revizion për arsye tërësisht formale, pa marrë parasysh thelbin e pretendimeve të tij ankimore.
64. Duke pasur parasysh këtë, Gjykata fillimisht vë në dukje se çështja e refuzimit apo moslejimit të revizionit për shkak se e njëjta nuk e arrin vlerën e përcaktuar me ligj hyn në kuadër të parimit apo të drejtës për qasje në gjykatë, të garantuar me nenin 31 të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6 të KEDNj-së (shih rastin e Gjykatës KI96/22, parashtrues *Naser Husaj dhe Ulis Husaj*, Aktvendim për papranueshmëri, i 29 gushtit 2023, paragrafi 49). Rrjedhimisht, mohimi i së drejtës për qasje në gjykatë mund të ketë si pasojë edhe mohimin e mjetit efektiv juridik dhe të mbrojtjes gjyqësore të të drejtave, për të cilat parashtruesi i kërkesës pretendon se i janë shkelur nga konkluzioni arbitrar i Gjykatës Supreme, në lidhje me vlerësimin e vlerës së objektit të kontestit, si parakusht për të vlerësuar meritat e rastit (shih rastin e Gjykatës [KI143/21](#), parashtrues *Avdyl Bajgora*, Aktgjykim i 25 nëntorit 2021, paragrafi 60).
65. Thënë këtë, Gjykata i referohet përfundimit të Gjykatës Supreme se revizioni i parashtruesit të kërkesës nuk është i lejuar për arsye se, "*Me nenin 508, të LPK-së, përcaktohet se: "Revizioni në kontestet tregtare nuk lejohet në qoftë se vlera e objektit të kontestit në pjesën e goditur të aktgjyqimit të formës së prerë nuk i kalon 10, 000 €", ku "Me nenin 30, paragrafi 1 të LPK-së, përcaktohet se: "Paditësi ka për detyrë që në kontestet pasurore - juridike, në padi të përcaktoj vlerën e objektit të kontestit ..."*.
66. Duke marrë parasysh sa më sipër, rrethanat e rastit konkret ndërliiden me faktin nëse Gjykata Supreme, duke e shpallur "*të palejuar revizionin*" për çështje tërësisht ligjore/procedurale, ka ndikuar në mënyrë joproporcionale në mundësinë e parashtruesit të kërkesës për të marrë një vendim meritator për rastin e tij nga Gjykata Supreme (shih rastin e Gjykatës KI96/22, parashtrues *Naser Husaj dhe Ulis Husaj*, cituar më lart, paragrafi 50).
67. Gjykata, duke u bazuar në praktikën e saj gjyqësore dhe atë të GjEDNj-së në parim ka theksuar se e drejta e qasjes në gjykatë duhet të jetë "*praktike dhe efektive*" dhe jo "*teorike dhe iluzore*" (shih, ndër të tjera, rastet e Gjykatës [KI20/21](#), parashtruese *Violeta Todorović*, Aktgjykim i 13 prillit 2021, paragrafi 43 dhe [KI224/19](#), parashtrues *Islam Krasniqi*, Aktgjykim i 10 dhjetorit 2020, paragrafi 39; shih gjithashtu rastin e GjEDNj-së [Famullia Katolike Greke e Lupenit kundër Rumanisë \[DHM\]](#), nr. 76943/11, Aktgjykim i 29 nëntorit 2016, paragrafi 84). Sipas praktikës gjyqësore të Gjykatës dhe asaj të GjEDNj-së kjo e drejtë nuk është absolute, por mund t'i nënshtrohet kufizimeve të cilat nuk guxojnë të zvogëlojnë qasjen në gjykatë në atë mënyrë apo deri në një masë që cenojnë vetë thelbin e së drejtës. Kufizimet e tilla nuk do të jenë të arsyetuar nëse ato nuk ndjekin një qëllim legjitim ose nëse nuk ekziston një raport i arsyeshëm i proporcionalitetit midis mjeteve të përdorura dhe qëllimit që kërkohet të arrihet përmes tyre (shih rastet e Gjykatës KI96/22, parashtrues *Naser Husaj dhe Ulis Husaj*, cituar më lart, paragrafi 51; KI20/21, parashtruese *Violeta Todorović*, cituar më lart, paragrafi 45; dhe [KI54/21](#), parashtrues *Kamber Hoxha*, Aktgjykim i 4 nëntorit 2021, paragrafët 63-64; shih, gjithashtu, rastet e GjEDNj-së:

[Sotiris dhe Nikos Koutras ATTEE kundër Greqisë](#), nr. 39442/98, Aktgjykim i 16 nëntorit 2000, paragrafi 15; [Bëlesh dhe të tjerët kundër Republikës Çeke](#), nr. 47273/99, Aktgjykim i 12 nëntorit 2002, paragrafi 61; dhe [Famullia Katolike Greke e Lupenit kundër Rumanisë](#), cituar më lart, paragrafi 89).

I.Parimet e përgjithshme të qasjes në gjykatat më të larta dhe kufizimet racione valoris në këtë aspekt

68. Gjykata rikujton se neni 6 i KEDNj-së nuk i detyron Shtetet Kontraktuese të krijojnë gjykata të apelit ose të kasacionit. Sidoqoftë, në rastet kur ekzistojnë gjykata të tilla, duhet të respektohen garancitë e nenit 6 të KEDNj-së, dhe për rrjedhojë ato duhet t'u garantojnë palëve ndërgjyqëse të drejtën efektive të qasjes në gjykata për të vendosur mbi "të drejtat dhe detyrimet e tyre civile" (shih [Andrejeva kundër Letonisë](#), nr. 55707/00, Aktgjykim i 18 shkurtit 2009, paragrafi 97, shih, gjithashtu [Levages Prestations Services kundër Francës](#), nr. 21920/93, Aktgjykim i 23 tetorit 1996, paragrafi 44, dhe [Brualla Gómez de la Torre kundër Spanjës](#), nr. 26737/95, Aktgjykim i 19 dhjetorit 1997, paragrafi 37).
69. Megjithatë, nuk është detyrë e Gjykatës të krijojë qëndrimin e saj nëse politikat e përzgjedhura nga palët kontraktuese, të cilat përcaktojnë kufizimet e qasjes në gjykatë, janë të përshtatshme apo jo; detyra e saj është e kufizuar vetëm në përcaktimin nëse zgjedhjet e tyre në këtë fushë kanë prodhuar pasoja që janë në përputhje me KEDNj. Në mënyrë të ngjashme, roli i Gjykatës nuk është zgjidhja e mosmarrëveshjeve lidhur me interpretimin e ligjit të brendshëm që rregullon këtë qasje, por përcaktimi nëse efektet e një interpretimi të tillë janë në përputhje me KEDNj (shih, rastet e GjEDNj-së, [Platakou kundër Greqisë](#), nr. 38460/97, Aktgjykim i 1 janarit 2001, paragrafët 37-39, [Yagtzilar dhe të tjerët kundër Greqisë](#), nr. 41727/98, Aktgjykim i 6 dhjetorit 2001, paragrafi 25, dhe [Bulfracht Ltd kundër Kroacisë](#), nr. 53261/08, Aktgjykim i 21 qershorit 2011, paragrafi 35).
70. Në këtë kuptim duhet ritheksuar se mënyra në të cilën neni 6, paragrafi 1 zbatohet në gjykatat e apelit ose të kasacionit varet nga veçoritë e veçanta të procedurës konkrete dhe se duhet marrë parasysh tërësia e procedurës së ndërmarrë në rendin e brendshëm juridik, si dhe roli i gjykatës së kasacionit në të; kushtet e pranueshmërisë së revizionit mund të jenë më të rrepta se ato për një ankesë të rregullt (shih rastin e cituar më lart [Levages Prestations Services](#), paragrafi 45; rastin e cituar më lart [Brualla Gómez de la Torre](#), paragrafi 37; dhe [Kozlica kundër Kroacisë](#), nr. 29182/03, Aktgjykim i 2 nëntorit 2006, paragrafi 32; shih, gjithashtu rastin [Shamoyan kundër Armenisë](#), nr. 18499/08, Aktgjykimi i 7 korrikut 2015, paragrafi 29).
71. Gjykata më tej pranoi se aplikimi i pragut ligjor *ratione valoris* për ankesat në Gjykatën Supreme është një supozim procedural legjitim dhe i arsyeshëm, duke pasur parasysh vetë thelbin e rolit të Gjykatës Supreme që ajo të merret vetëm me çështje të rëndësishme të veçantë (shih, GjEDNj, [Brualla Gómez de la Torre](#), paragrafi 36; rastin [Kozlica](#), paragrafi 33; rastin e cituar më lart [Bulfracht LTD](#), paragrafi 34, [Dobrić kundër Serbisë](#), nr. 2611/07 dhe 15276/07, Aktgjykim i 21 qershorit 2011, paragrafi 54; dhe [Jovanović kundër Serbisë](#), nr. 32299/08, Aktgjykim i 2 tetorit 2012, paragrafi 48).
72. Për më tepër, kur vendosi për çështjet nëse procedurat para gjykatave të apelit ose të kasacionit janë në përputhje me kërkesat e nenit 6, paragrafi 1, Gjykata mori parasysh shkallën në të cilën çështja ishte shqyrtuar para gjykatave më të ulëta, (mos) ekzistencën e çështjeve që lidhen me drejtësinë e procedurave të zhvilluara para gjykatave më të ulëta, si dhe natyrën e rolit të gjykatës në fjalë (shih, për konsideratat përkatëse, [Levages Prestations Services](#), paragrafët 45-49; rastin e cituar më lart

Brualla Gómez de la Torre, paragrafët 37-39; Sotiris dhe Nikos Koutras ATTEE kundër Greqisë, nr. 39442/98, Vendimi i 19 dhjetorit 1998, paragrafi 22; dhe Nakov kundër ish-Republikës Jugosllave të Maqedonisë nr. 68286/01, Vendim i 24 tetorit 2002).

73. Thënë këtë, Gjykata i referohet rastit të Dhomës së Madhe të GjEDNj-së në rastin Zubac kundër Kroacisë, nr. 40160/12, Aktgjykim i 5 prillit 2018, përmes të cilit në lidhje me çështjen e lejueshmërisë së revizionit e që ndërlidhet me pragun e vlerës së përcaktuar me ligj, në parim kishte ritheksuar se: “*Mënyra se si zbatohet neni 6, paragrafi 1 [të KEDNj-së] në gjykatat e apelit dhe të kasacionit varet nga veçoritë e veçanta të procedurës para atyre gjykatave. Kushtet e pranueshmërisë së revizionit mund të jenë më të rrepta se ato për një ankesë të rregullt*” (shih paragrafin 82 të Aktgjykimit dhe referencat e përdorura aty, siç është rasti Kozlica kundër Kroacisë, nr. 29182/03, Aktgjykim i 2 nëntorit 2006, paragrafi 32). Në vijim të kësaj, GjEDNj po në të njëjtin rast kishte theksuar se: “*Aplikimi i pragut ligjor **ratione valoris** për revizionin në Gjykatën Supreme është supozim procedural legjitim dhe i arsyeshëm duke pasur parasysh se gjykata merret vetëm me çështje të rëndësishme të veçantë*” (shih paragrafin 83 të Aktgjykimit në rastin Zubac kundër Kroacisë dhe referencat e përdorura në këtë rast, ndër të tjera, rastin Jovanović kundër Serbisë, nr. 32299/08, Aktgjykim i 2 tetorit 2012, paragrafi 48; si dhe shih rastin e Gjykatës KI96/22, parashtrues Naser Husaj dhe Ulks Husaj, cituar më lart, paragrafi 52).
74. Në këtë kuptim, GjEDNj po në rastin Zubac kundër Kroacisë, dhe në lidhje me zbatimin e kufizimeve ligjore **ratione valoris** për qasje në gjykatat më të larta, zhvilloi një test trehapësh, përmes të cilit duhet të shqyrtohen dhe vlerësohen: (i) parashikueshmëria e kufizimeve; (ii) çështja nëse parashtruesi apo shteti duhet t'i bartë pasojat e dëmshme të gabimeve të kryera gjatë procedurës; dhe (iii) çështja e “formalizmit të tepruar” në zbatimin e kufizimeve (shih paragrafët 80-86 të aktgjykimit në rastin Zubac kundër Kroacisë, dhe referencat e përdorura në këtë aktgjykim; si dhe shih rastin e Gjykatës KI96/22, parashtrues Naser Husaj dhe Ulks Husaj, cituar më lart, paragrafi 53).
75. Në lidhje me të parën, GjEDNj specifikoi se (i) çështja e mjetit ligjor në këtë rast ishte e parashikueshme nga këndvështrimi i palëve ndërgjyqëse. Në këtë kuptim, GjEDNj shtoi se (ii) supozimi se kufizimi i qasjes është i parashikueshëm plotësohet nëse ka praktikë koherente gjyqësore dhe (iii) zbatim konsistent të kësaj praktike, dhe në vijim po ashtu vlerësoi se (iv) merr parasysh qasjen e parashtruesit në praktikën përkatëse gjyqësore dhe (v) nëse i njëjti përfaqësohet nga një avokat i kualifikuar (shih paragrafët 87-89 të Aktgjykimit në rastin Zubac kundër Kroacisë; shih, po ashtu, rastin e Gjykatës KI96/22, parashtrues Naser Husaj dhe Ulks Husaj, cituar më lart, paragrafi 54).
76. Në lidhje me të dytën, GjEDNj theksoi se duhet të përcaktohet nëse parashtruesi ka qenë i përfaqësuar gjatë procedurave, si dhe nëse ai ka treguar zellin e duhur në ndërmarrjen e veprimeve përkatëse procedurale, duke vijuar me përcaktimin e çështjes nëse gabimet mund të ishin shmangur që në fillim dhe nëse gabimet mund t'i atribuohen kryesisht parashtruesit apo autoriteteve kompetente (shih paragrafët 90-95 të aktgjykimit në rastin Zubac kundër Kroacisë; si dhe shih rastin e Gjykatës KI96/22, parashtrues Naser Husaj dhe Ulks Husaj, cituar më lart, paragrafi 55).
77. Në lidhje me të tretën, përkatësisht me çështjen e formalizmit të tepruar, GjEDNj theksoi se formalizmi i tepruar nga ana e gjykatave mund të jetë në kundërshtim me të drejtën për qasje në gjykatë. Në këtë kuptim, GjEDNj kishte theksuar se, “*megjithatë, e drejta për qasje në gjykatë konsiderohet se është dëmtuar në atë moment kur rregullat pushojnë të jenë në shërbim të sigurisë juridike dhe administrimit të duhur*”

të drejtësisë dhe për pasojë krijojnë një barriera e cila i pamundëson palëve ndërgjyqjësë që rasti i tyre të gjykohet në merita nga gjykata kompetente” (shih paragrafin 98 të Aktgjykimit në rastin *Zubac kundër Kroacisë*; si dhe shih rastin e Gjykatës KI96/22, parashtrues *Naser Husaj dhe Uliks Husaj*, cituar më lart, paragrafi 56).

78. Në vijim të kësaj, GjEDNj në rastin *Zubac kundër Kroacisë*, duke zbatuar parimet dhe testin e lartcekur të zhvilluar në këtë rast, konstatoi se kufizimi i qasjes në Gjykatën Supreme të Republikës së Kroacisë nuk ishte rezultat i rregullave procedurale jo fleksibile, gjegjësisht, ligji dhe praktika e brendshme gjyqësore përkatëse parashikojnë mundësinë e ndryshimit të vlerës së kontestit në një fazë më të hershme të procesit gjyqësor, gjë që mundëson qasje në Gjykatën Supreme në rast të ndryshimit të rrethanave të çështjes. Përveç kësaj, parashtruesja mund të kishte paraqitur një mjet tjetër të jashtëzakonshëm të përcaktuar me ligj që asaj do t'i mundësonte gjithashtu qasje në Gjykatën Supreme, gjë të cilën ajo nuk e kishte bërë. Në vijim të kësaj, GjEDNj kishte konstatuar se, “*Funksioni kryesor i Gjykatës Supreme, si gjykatës më të lartë në Kroaci, është të sigurojë zbatimin uniform të ligjit dhe barazinë e të gjithëve në zbatimin e tij*”. Kufizimi i qasjes në këtë gjykatë, duke vendosur një prag ligjor, *ratione valoris*, justifikohet nga qëllimi legjitim i Gjykatës Supreme që të merret vetëm me çështje të rëndësishme. Zgjidhja e parregullsive të kryera nga gjykatat më të ulëta në përcaktimin e vlerës së objektit të kontestit, synonte gjithashtu një qëllim legjitim, përkatësisht respektimin e sundimit të ligjit dhe funksionimin e duhur të sistemit gjyqësor (shih paragrafët 101-125 të Aktgjykimit në rastin *Zubac kundër Kroacisë*; si dhe shih rastin e Gjykatës KI96/22, parashtrues *Naser Husaj dhe Uliks Husaj*, cituar më lart, paragrafi 57).
79. Gjykata konsideron se në rrethana të tilla, gjykatat e rregullta gëzojnë një liri të gjerë të vlerësimit të mënyrës së zbatimit të kufizimeve përkatëse *ratione valoris* në këtë rast. Megjithatë, kjo nuk do të thotë se gjykatat gëzojnë diskrecion të pakufizuar në këtë kuptim. Me rastin e shqyrtimit nëse kjo liri e vlerësimit është tejkaluar, Gjykata duhet t'i kushtojë vëmendje të veçantë tre kritereve, përkatësisht (i) parashikueshmërisë së procedurës e cila zbatohet në lidhje me revizionin; (ii) çështjes se kush duhet t'i bartë pasojat e dëmshme të gabimeve të bëra gjatë procedurës, dhe (iii) çështjes nëse qasja e parashtruesit në Gjykatën Supreme është kufizuar nga formalizmi i tepruar.

II. Zbatimi i parimeve të përgjithshme të qasjes në gjykatat më të larta dhe kufizimet ratione valoris në rrethanat e rastit konkret

80. Prandaj, Gjykata në vijim do të zbatojë parimet dhe testin e lartcekur të zhvilluar nga GjEDNj në rrethanat e rastit konkret, përkatësisht (i) në lidhje me kriterin e parashikueshmërisë së kufizimit përmes pragut ligjor, do të vlerësojë nëse praktika gjyqësore e Gjykatës Supreme është konsistente dhe e qartë në lidhje me lejueshmërinë e revizionit; pastaj (ii) do të vlerësojë nëse kufizimi i qasjes në Gjykatën Supreme mund t'i atribuohet gabimit të parashtruesit të kërkesës; si dhe (iii) do të vlerësojë nëse Gjykata Supreme gjatë interpretimit dhe zbatimit të dispozitave ligjore në fuqi që ndërlidheshin me prapun e lejueshmërisë së revizionit kishte zbatuar formalizëm të tepruar.

(i) *Përkritazi me parashikueshmërinë e procedurës e cila zbatohet në lidhje me revizionin*

81. Në vijim të kësaj, dhe duke iu rikthyer rrethanave të rastit konkret, përkritazi me (i) çështjen e parashikueshmërisë së kufizimit, Gjykata, **së pari**, do të vlerësojë me kujdes mënyrën se si Gjykata Supreme e shqyrtoi revizionin e parashtruesit të

kërkesës për të përcaktuar nëse Gjykata Supreme ka një praktikë të konsoliduar gjyqësore në lidhje me pragun ligjor për lejueshmërinë e revizionit. Në mbështetje të kësaj, Gjykata vëren se në rendin juridik, qasja në Gjykatën Supreme në çështjet civile sigurohet përmes revizionit në bazë të nenit 211 të LPK-së. Revizioni i referohet kontesteve në të cilat pjesa e goditur e aktgjykimit tejkalon një prag të caktuar të vlerës. Atëherë kur arrihet ky prag i vlerës, qasja në Gjykatën Supreme bëhet çështje e së drejtës individuale. Në kuadër të revizionit, Gjykata Supreme mund të anulojë aktgjykimet e gjykatave më të ulëta dhe të kthejë rastin në rigjykim ose, në raste të caktuara, të ndryshojë aktgjykimin e kontestuar. Në çdo rast, Gjykata Supreme është e autorizuar të shpallë të palejuar çdo revizion i cili nuk i përmbush kushtet përkatëse ligjore.

82. Në rrethanat e rastit konkret, parashtruesi i kërkesës parashtrroi revizion në Gjykatën Supreme, duke pretenduar, ndër të tjera, se Gjykata Themelore nuk e kishte përcaktuar vlerën e kërkesëpadsisë. Gjykata Supreme e hodhi poshtë këtë revizion si të palejuar, duke theksuar se, *“me nenin 508 të LPK-së, përcaktohet se: “Revizioni në kontekstet tregtare nuk lejohet në qoftë se vlera e objektit të kontestit në pjesën e goditur të aktgjykimit të formës së prerë nuk i kalon 10,000 €”*. Pra, Gjykata Supreme iu referua nenit 508 (Pa titull) të Ligjit për Procedurën Kontestimore, sipas të cilit revizioni nuk mund të paraqitet në kontestet tregtare në qoftë se vlera e kontestit nuk kalon shumë prej 10,000 euro. Prandaj, një vendim i tillë ishte në përputhje me praktikën e zakonshme të Gjykatës Supreme lidhur me këtë çështje, dhe kjo mund të konstatohet edhe nga arsyetimi i saj, ku thuhet:

“Nga interpretimi i këtyre dispozitave ligjore, Gjykata Supreme erdhi në përfundim se revizioni nuk lejohet kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës Ac. nr. 306/18, të datës 04.08.2020, për arsye se dispozitat e cituara i referohen lejueshmërisë së revizionit e kushtëzuar me vlerën e kontestit e cila duhet të jetë mbi 10,000 €, për të qenë i lejuar revizioni, dhe situatës kur revizioni lejohet pavarësisht vlerës së kontestit sipas kriterit përjashtues për natyrën e çështjes kontestuese. Në këtë rast vlera e kontestit e goditur me revizion nuk është mbi 10,000 €, gjegjësisht pala paditëse me padi nuk e ka përcaktuar vlerën e kontestit, e nëse i referohemi taksës gjyqësore për padi në lartësi prej 15 €, të cilën e ka paguar pala paditëse, nuk e tejkalon vlerën e kontestit mbi 10,000 €, bazuar në udhëzimet administrative për unifikimet e taksave gjyqësore dhe po ashtu natyra e kontestit nuk përbën përjashtim për lejueshmërinë e revizionit (përjashtimet pavarësisht vlerës), prandaj në këtë rast për shkak të vlerës së kontestit, revizioni është i palejuar”.

83. Prandaj, Gjykata vëren se Gjykata Supreme e hodhi poshtë si të palejuar revizionin e paraqitur nga parashtruesi i kërkesës, duke arritur në përfundimin se vlera përkatëse e objektit të kontestit është nën minimumin ligjor. Gjatë vlerësimit të pranueshmërisë *ratione valoris*, Gjykata Supreme iu referua nenit 508 (Pa titull) të LPK-së, i cili specifikon se, *“Revizioni në kontekstet tregtare nuk lejohet në qoftë se vlera e objektit të kontestit në pjesën e goditur të aktgjykimit të formës së prerë nuk i kalon 10,000 €”*. Përveç kësaj, si udhëzim për përcaktimin e vlerës së kontestit, Gjykata Supreme theksoi edhe faktin se *“parashtruesi i kërkesës ka paguar taksën për paraqitjen e kërkesëpadsisë në lartësi prej 15 euro”*.
84. Gjithashtu, Gjykata vëren se në arsyetimin e saj Gjykata Supreme iu referua dhe ka vepruar në përputhje me dispozitën ligjore të nenit 30, paragrafin 1 dhe 2 si dhe nenit 508 të LPK-së, i cili në mënyrë konkrete përcakton kufizimin ligjor të shqyrtimit të revizionit, pa marrë parasysh paraprakisht se vlera e kontestit nuk është përcaktuar, përkatësisht se vlera e kontestit nuk është përcaktuar fare as nga parashtruesi i kërkesës dhe as nga gjykata kompetente.

85. Rrjedhimisht, Gjykata konstaton se dispozitat ligjore të referuara nga Gjykata Supreme sigurisht përmbajnë kufizime në lidhje me aprovimin e revizionit në kuptimin formal dhe si i tillë, ai është i qartë dhe i parashikueshëm si për parashtruesin e kërkesës ashtu edhe për Gjykatën. Mirëpo, parashikueshmëria e kufizimeve ligjore dhe zbatimi i tyre varen sipas rastit, dhe ato, si të tilla, duhet të jenë objekt i një vlerësimi gjithëpërfshirës, ku në vlerësimin e tyre duhet shmangur qasja formaliste kur kufizimet zbatohen në një rast konkret.

(ii) *Përkritazi me atë se kush duhet t'i bartë pasojat e dëmshme të gabimeve të kryera gjatë procedurës*

86. Duke shqyrtuar me kujdes kushtin e dytë (ii) nëse kufizimi i qasjes në Gjykatën Supreme mund t'i atribuohet gabimeve të parashtruesit të kërkesës, Gjykata, për të arritur një përgjigje, duhet të ketë parasysh vetë fillimin e paraqitjes së kërkesëpadisë si dhe dispozitat ligjore të LPK-së, të cilat rregullojnë çështjen dhe procedurën e përcaktimit të vlerës së kontestit me rastin e paraqitjes së kërkesëpadisë.

87. Pikërisht në mbështetje të kësaj, Gjykata rikujton se kufizimi i qasjes në Gjykatën Supreme mbulohet nga qëllimi legjitim i pranuar përgjithësisht i pragut ligjor *ratione valoris* për ankesat në Gjykatën Supreme, qëllimi i të cilit është të sigurojë se Gjykata Supreme, duke pasur parasysh vetë thelbin e rolit të saj, të merret vetëm me çështjet me rëndësi. Në mbështetje të kësaj, Gjykata rikujton se roli i Gjykatës Supreme, ndër të tjera, është të sigurojë zbatim unik të ligjit, si dhe barazinë e të gjithëve në zbatimin e tij. Duke pasur parasysh këtë funksion, Gjykata e sheh të nevojshme të vlerësojë nëse vendimi i Gjykatës Supreme ndjek një qëllim legjitim, përkatësisht respektimin e sundimit të ligjit dhe funksionimin e duhur të sistemit të drejtësisë.

88. Lidhur me këtë, Gjykata do të shqyrtojë me kujdes shkallën në të cilën rasti i parashtruesit të kërkesës është adresuar para gjykatave më të ulëta, më konkretisht sa është adresuar kërkesa e tij për përcaktimin e vlerës së kontestit, si dhe natyrën e rolit të Gjykatës Supreme.

89. Prandaj, për Gjykatën nuk është kontestues fakti se parashtruesi i kërkesës ka paraqitur padi në Gjykatën Themelore pa specifikuar vlerën e kërkesëpadisë, edhe pse neni 30.1 i LPK-së thotë se "*Paditësi ka për detyrë që, në kontestet pasurore-juridike, në padi të përcaktojë vlerën e objektit të kontestit [...]*".

90. Megjithatë, Gjykata i referohet përcaktimeve të nenit 36 të LPK-së, i cili përcakton si në vijim:

Neni 36

Në qoftë se paditësi nuk e ka përmendur fare vlerën e objektit të kontestit në padinë e paraqitur në gjykatë, apo në qoftë se ai vlerën e tillë e ka caktuar tepër të lartë apo shumë më të vogël se që është ajo realisht, atëherë gjykata sipas detyrës zyrtare, apo sipas prapësimit të palës së paditur, më së voni në seancën përgatitore, e nëse kjo nuk është mbajtur, atëherë në seancën për shqyrtimin kryesor të çështjes juridike, por para se të filloj shqyrtimi i çështjes kryesore, shpejtë dhe në mënyrë të përshtatshme do ta caktoj, përkatësisht do ta verifikojë saktësinë e vlerës së treguar në padi nga paditësi. Në rast të këtyllë gjykata vendosë me aktvendim kundër të cilit nuk lejohet ankimi.

91. Rrjedhimisht, nga teksti i dispozitës ligjore të nenit 36 të LPK-së shihet se vlera e objektit të kontestit është një nga elementet e padisë, përcaktimi i së cilës është element i cili është i përcaktuar me ligj, por nuk është parakusht i domosdoshëm për

ngritjen e padisë. Prandaj, edhe në rastet kur pala nuk e ka përcaktuar vlerën e objektit të kontestit në momentin e paraqitjes së kërkesëpadisë, gjykata nuk do ta refuzojë padinë dhe as nuk do t'ia kthejë padinë paditësit për korrigjim.

92. Me fjalë të tjera, në rastet kur paditësi nuk e ka caktuar vlerën e objektit të kontestit ose në qoftë se e ka caktuar vlerën e tij shumë të vogël ose tepër të lartë, gjykata sipas detyrës zyrtare apo sipas prapësimit të palës së paditur, më së voni në seancën përgatitore, e nëse seanca përgatitore nuk është mbajtur, atëherë para fillimit të shqyrtimit kryesor përshtatshëmrisht cakton vlerën e objektit të kontestit, duke marrë parasysh rrethanat objektive të kërkesëpadisë në fjalë.
93. Gjkata gjen se dispozita ligjore e nenit 36 të LPK-së është mjaft e qartë, si në aspektin e të drejtave ashtu edhe në aspektin e veprimeve dhe detyrimeve procedurale, dhe përcakton qartë se Gjkata Themelore ka detyrimin që sipas detyrës zyrtare të caktojë vlerën e kontestit në 3 situata të ndryshme, dhe ato janë: i) *kur paditësi nuk e ka caktuar vlerën e kontestit*, ii) *kur paditësi e ka caktuar vlerën shumë të vogël të kontestit*; dhe iii) *kur paditësi e ka caktuar vlerën tepër të lartë të kontestit*. Për më tepër, detyrimi i Gjykatës Themelore, kur paraqitet një kërkesëpadi nga neni 36 i LPK-së, është të caktojë vlerën e objektit të kontestit sipas detyrës zyrtare dhe atë me aktvendim para fillimit të seancës së shqyrtimit kryesor. Prandaj, parakushti që Gjkata të mund të veprojë sipas kërkesëpadisë në merita është që fillimisht të caktojë vlerën e kontestit në fjalë përmes një aktvendimi të veçantë në një seancë të posaçme.
94. Për sa i përket mënyrës së përcaktimit dhe verifikimit të vlerës së objektit të kontestit, gjykata është e detyruar që sipas kritereve objektive të përcaktojë ekuivalentin monetar të kërkesëpadisë në bazë të të dhënave nga padia dhe vetëm nëse kjo është e mundur për nga natyra e çështjes, gjegjësisht të përcaktojë paraprakisht vlerën e objektit të kontestit, përkatësisht nëse vlera e objektit të kontestit është shënuar dhe nëse ajo është shënuar si tepër e lartë apo shumë e ulët. Ky verifikim zbatohet deri në kufirin e probabilitetit të pranueshëm, sepse çdo shqyrtim më i thellë i problemit, përkatësisht kërkesëpadisë, do të rrezikonte realizimin e detyrës themelore të gjykatës, që është sigurimi i mbrojtjes juridike.
95. Prandaj, vetë fakti se parashtruesi i kërkesës i kërkoi Gjykatës Themelore që ajo të përcaktojë vlerën e kontestit e kualifikon kërkesëpadinë e tij si kërkesëpadinë e kategorisë i) *kur paditësi nuk e ka përcaktuar vlerën e kontestit* nga neni 36 i LPK-së, sipas së cilës kishte iniciuar procedurën në të cilën Gjkata Themelore ka për obligim të merret me këtë kërkesë sipas detyrës zyrtare.
96. Më konkretisht, Gjkata vëren se parashtruesi i kërkesës gjatë procedurës së paraqitjes së kërkesëpadisë, kishte paraqitur kërkesën për përcaktimin e vlerës së objektit të kontestit, dhe rrjedhimisht, mospërcaktimi i vlerës së objektit të kontestit nga gjykatat e rregullta sipas mendimit të kësaj Gjykate, nuk mund t'i atribuohen objektivisht parashtruesit. Për më tepër, Gjkata konstaton se parashtruesi i kërkesës ka bërë përpjekje për të kontribuar në korrigjimin e mos përcaktimit të vlerës së kontestit nga ana e Gjykatës Themelore, a) duke paraqitur propozimin për kryerjen e ekspertizës plotësuese e cila do të kontribuonte në përcaktimin e vlerës së kontestit, të cilin propozim Gjkata Themelore e hodhi poshtë me aktvendimin e saj, dhe b) duke parashtruar ankesën në Gjykatën e Apelit me qëllim të trajtimit të kësaj çështje.
97. Gjkata thekson që nuk është kontestuese që parashtruesi i kërkesës me rastin e paraqitjes së kërkesëpadisë në pajtim me vlerën e objektit të kontestit, duhet të paguajë edhe taksën gjyqësore të përcaktuar me Udhëzimin Administrativ të Këshillit Gjyqësor të Kosovës. Në thelb, pagesa e taksës në shumë prej 15 euro nuk mund të shërbejë si parametër i vetëm për caktimin e vlerës së kontestit në fjalë, sidomos për

arsye se parashtruesi i kërkesës ka paguar taksën gjyqësore në vlerë prej 15 euro si një shumë të kushtëzuar që pala është e detyruar të paguajë kur nuk dihet vlera e kontestit, ndërsa vetë taksa në shumë prej 15 euro është kusht i cili i mundëson palës që kërkesëpadia e saj të pranohet nga gjykata në kuptimin procedural, dhe jo të hidhet poshtë si një kërkesëpadi e paplotë para fillimit të procedurës.

98. Në përputhje me sa më sipër, duket se parashtruesi i kërkesës ka treguar kujdesin e duhur në përpjekje për të përcaktuar vlerën e kontestit, gjë që është në pajtim me dispozitat përkatëse ligjore. Gjykata është e mendimit se gabimet në procedurë mund të ishin evituar që në fillim, në qoftë se Gjykata Themelore do të kishte vepruar në pajtim me dispozitën ligjore të nenit 36 të LPK-së. Nga kjo rezulton se këto gabime nuk mund t'i atribuohen parashtruesit të kërkesës.

iii) përkiazi me përdorimin e formalizmit të tepruar gjatë interpretimit dhe zbatimit të dispozitave ligjore në fuqi lidhur me pragun e lejueshmërisë së revizionit

99. Për sa i përket vlerësimit të përmbushjes së kriterit të tretë, respektivisht nëse është përdorur formalizëm i tepruar gjatë interpretimit dhe zbatimit të dispozitave ligjore në fuqi lidhur me pragun e lejueshmërisë së revizionit, Gjykata thekson se respektimi i rregullave formale të procedurës kontestimore, përmes së cilës palët sigurojnë vendimmarrjen për kontestin civil, është i vlefshëm dhe i rëndësishëm sepse kështu mund të kufizohet liria diskrecionale, të sigurohet barazia e armëve, të parandalohet arbitrariteti dhe të sigurohen efektiviteti gjatë vendimmarrjes për kontestin dhe gjykimi brenda një afati të arsyeshëm, si dhe siguria juridike dhe respektimi i gjykatës.
100. Megjithatë, në praktikën gjyqësore të GjEDNj-së është përcaktuar se “formalizmi i tepruar” mund të jetë në kundërshtim me kërkesën për të siguruar të drejtën praktike dhe efektive për qasje në gjykatë bazuar në nenin 6, paragrafi 1 të KEDNj-së. Kjo zakonisht ndodh në rastet e një interpretimi të rreptë të një rregulli procedural që pengon shqyrtimin e meritave të padisë së parashtruesit të kërkesës, me rrezikun përkatës se do të cenohet e drejta e tij apo e saj për mbrojtje efikase gjyqësore (shih rastet e GjEDNj-së [Bëlesh dhe të tjerët kundër Republikës Çeke](#), nr. 47273/99, Vendim i 12 nëntorit 2002, paragrafët 50-51 dhe 69, dhe [Walchli kundër Francës](#), nr. 35787/03, Aktgjykim i 26 korrikut 2007, paragrafi 29).
101. Prandaj, në rastin konkret, Gjykata Supreme nuk do duhej të ishte e lidhur nga gabimet e gjykatave më të ulëta gjatë vendosjes nëse do t'i mundësojë qasjen parashtruesit të kërkesës, por duhet të kishte shqyrtuar nëse qasja tek ajo ishte pamundësuar nga lëshimet procedurale të gjykatave të shkallës më të ulët.
102. Gjykata thekson që nuk është kontestuese kompetenca e Gjykatës Supreme, e përcaktuar me ligj, që para vlerësimit të revizionit në merita të shqyrtojë lejueshmërinë e revizionit në kuptim të pragut *ratione valoris*, bazuar në nenin 508 (pa titull) të Ligjit për Procedurën Kontestimore. Megjithatë, Gjykata thekson se thirrja e Gjykatës Supreme në dispozitën ligjore të nenit 508 të LPK-së dhe dhënia e arsyesimit pa shqyrtimin paraprak të lëshimit të mundshëm procedural, se “*Revizioni në kontestet tregtare nuk lejohet në qoftë se vlera e objektit të kontestit në pjesën e goditur të aktgjykimit të formës së prerë nuk i kalon 10,000 €*”, duke e kaluar përgjegjësinë dhe gabimin vetëm mbi parashtruesin e kërkesës dhe duke e arsyetuar këtë me faktin se në bazë të nenit 30, paragrafi 1 të LPK-së është përcaktuar se: “*revizioni është i palejuar, paditësi ka për detyrë që, në kontestet pasurore-juridike, në padi të përcaktoj vlerën e objektit të kontestit...*”, sipas konkluzionit të Gjykatës, përbën formalizëm të tepruar në interpretimin e rregulloreve ligjore, sidomos për arsye se Gjykata Supreme nuk ka marrë parasysh nenin 36 të LPK-së dhe, në qoftë se

do të kishte bërë këtë dhe sikur të kishte shqyrtuar dispozitën në rrethanat e rastit konkret, ajo mund të kishte arritur në përfundimin e saj për lëshimet ose gabimet e mundshme të kryera në radhë të parë nga Gjykata Themelore, e në procedurën e mëtejshme edhe nga Gjykata e Apelit.

103. Në këto rrethana, duke marrë parasysh se për rastin e parashtruesit të kërkesës kanë vendosur dy instanca të gjykatave të rregullta, ajo Themelore dhe e Apelit, të cilat kishin juridiksion të plotë në këtë rast, se parashtruesi i kërkesës ngriti çështjen e lëshimit të tyre të dukshëm, dhe se roli i Gjykatës Supreme është edhe rishikimi i zbatimit të ligjit në fuqi nga gjykatat e shkallës më të ulët, mund të thuhet se vendimi i Gjykatës Supreme në rastin konkret përbënte një pengesë joproporcionale që cenon vetë thelbin e të drejtës së parashtruesit të kërkesës, të garantuar me nenin 31, paragrafin 1 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6, paragrafin 1 të KEDNj-së dhe se e njëjta ka tejkaluar lirinë e vlerësimit.
104. Gjykata gjithashtu thekson se, konstatimi nga ana e saj i shkeljes së paragrafit 1 të nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me paragrafin 1 të nenit 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, vlen vetëm për rrethanat specifike të rastit konkret, vlerësimi i të cilave duhet të bëhet rast pas rasti, si dhe ndërlidhet vetëm me të drejtën e qasjes në gjykatë, përkatësisht në Gjykatën Supreme, ashtu që në asnjë mënyrë nuk paragjykon rezultatin e meritave të rastit.

Përfundim

105. Si përmbledhje, Gjykata, duke u bazuar në analizën e mësipërme, konkludoi se Aktvendimi i kontestuar [E. Rev. nr. 75/20] i Gjykatës Supreme të Kosovës, i 1 gushtit 2022, shkel të drejtat kushtetuese të parashtruesit të kërkesës të garantuara me paragrafin 1 të nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës, në lidhje me paragrafin 1 të nenit 6 [E drejta për një proces të rregullt] të KEDNj-së.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me paragrafët 1 dhe 7 të nenit 113 të Kushtetutës, në përputhje me nenet 20 dhe 47 të Ligjit si dhe me rregullin 48 (1) (a) të Rregullores së punës, më 30 maj 2024,

VENDOS

- I. TË DEKLAROJË, me shtatë (7) vota për dhe një (1) votë kundër, kërkesën të pranueshme;
- II. TË KONSTATOJË, me shtatë (7) vota për dhe një (1) votë kundër, se ka pasur shkelje të paragrafit 1 të nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës në lidhje me paragrafin 1 të nenit 6 (E drejta për një proces të rregullt) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut;
- III. TË SHPALLË, me shtatë (7) vota për dhe një (1) votë kundër, të pavlefshëm Aktvendimin [E. Rev. nr. 75/20] e Gjykatës Supreme të Kosovës, të 1 gushtit 2022;
- IV. TA KTHEJË, me shtatë (7) vota për dhe një (1) votë kundër, Aktvendimin [E. Rev. nr. 75/20] e Gjykatës Supreme të Kosovës të 1 gushtit 2022, këtij të fundit për rivendosje, në pajtim me konstatimet e Gjykatës në këtë Aktgjykim;
- V. TË URDHËROJË Gjykatën Supreme që ta njoftojë Gjykatën, në pajtim me paragrafin (5) të rregullit 60 të Rregullores së punës, lidhur me masat e ndërmarra për zbatimin e Aktgjykimit të Gjykatës më së largu deri më 30 nëntor 2024;
- VI. T'UA KUMTOJË këtë Aktgjykim palëve;
- VII. TË PUBLIKOJË këtë Aktgjykim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me paragrafin 4 të nenit 20 të Ligjit;
- VIII. TË KONSTATOJË që ky Aktgjykim hyn në fuqi në ditën e shpalljes në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës, në pajtim me paragrafin 5 të nenit 20 të Ligjit.

Gjyqtarja raportuese


Remzije Istrefi-Peci

Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese




Gresa Caka-Nimani